



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 13 korrik 2022, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar

AMA, në këtë mbledhje mori në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së licencës/autorizimit të disa subjekteve audio/audiovizivë, në zbatim të përcaktimeve të ligjit organik nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, përkatësisht neneve 68 dhe 69 të tij.

Autoriteti, pasi shqyrtoi materialet përkatëse, pasi dëgjoi përfaqësuesit e subjekteve dhe u njoh me shkaqet e parashtruara prej tyre, ra dakord t’u caktojë subjekteve audio/audiovizive, si afat të fundit, për depozitimin e dokumentacionit për rinovim licence/autorizimi dhe/ose për ofrimin e shërbimit audio/audioviziv, datën 31 korrik 2022, si dhe rast pas rasti, shlyerjen e detyrimeve financiare përmes pagesës me këste.

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

- Dhënie e 12 autorizimeve, shoqërisë “TIBO AL” sh.p.k., me NIPT: M02219020Q dhe administrator zj. Blerina Kapaj, për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online mbështetur në rrjet IP (OTT), (“T-ACTION”; “T-DRAMA”; “T-THRILLER”; “T-PRIME 1”; “T PRIME 2”; “T SERIAL”; “T COMEDY”; “T-DOC 1”; “T DOC 2”; “TIBO NEWS”; “DING DONG”; “CLOVER”. (Vendimet nr. 70 - 81, datë 13.07.2022)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 13 korrik 2022